



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA E KOSOVË / REPUBLIC OF KOSOVO		AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Objekt:	20/DPK	Nr. Prot.:	01-4281/13
Titull:		Prot. No.:	
Nr. Dokument:	02	Data:	16.12.2013
Nr. Dokument:		Data:	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 24 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 02/2013 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 13.12.2013, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-3293/13, për z. Veton Misiri – Auditor i lartë në Zyren e Auditorit të Përgjithshëm, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funkcionit Publik për zyrtarin e lartë, z. Veton Misiri – Auditor i lartë në Zyren e Auditorit të Përgjithshëm, dhe njëkohësisht person i autorizuar në biznesin privat Sh.P.K “Konto & Consulting”, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Në rastin e lartëpërmendur, zyrtari i lartë z. Misiri është hetuar për situatë të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit (me datë 08.11.2013), pas së cilës zyrtari është paraqitur në takim me zyrtarët e Agjencisë. Me këtë rast ai është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet si dhe me ndryshimet të cilat duhet ti bëj për të parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit.

Zyrtari i lartë z. Misiri, në këtë takim ka deklaruar se brenda afatit ligjor do të heq dorë nga të qenurit person i autorizuar në biznesin privat dhe do të vazhdoj të ushroj funksionin e tij publik.

Zyrtari i lartë, z. Misiri ka dërguar në Agjenci informacionin zyrtar të lëshuar nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë(DPKI.03- 4214/13) në të cilën vërtetohet se i njëjti ka hequr dorë nga pozita e personit të autorizuar që kishte në Sh.P.K. “Konto & Consulting”, për të ushtruar funksionin e tij publik si Auditor i lartë në Zyren e Auditorit të Përgjithshëm, me çka ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

